

20150100165

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR HUAMARRJE TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN "REHABILITIMI I
PJESËS LINDORE TË HEKURUDHËS SË KORRIDORIT VIII, FAZA 1 SEGMENTI
KUMANOVË-BELAKOVÇ"**

Neni 1

Në Ligjin për huamarrje të Republikës së Maqedonisë të Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim sipas Marrëveshjes për hua për Projektin "Rehabilitimi i pjesës lindore të hekurudhës së Korridorit VIII, faza 1 segmenti Kumanovë-Belakovc" ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 100/12) neni 2 ndryshohet si vijon:

"Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshje për ndryshim dhe riformulim numër 1 të Marrëveshjes për hua nga 21.08.2012 për Projektin "Rehabilitimi i pjesës lindore të hekurudhës së Korridorit VIII, faza 1 segmenti Kumanovë-Belakovc", që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në emër të Republikës së Maqedonisë Marrëveshjen për ndryshim dhe riformulim numër 1 të Marrëveshjes për hua nga 21.08.2012 nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij."

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Për realizimin e projektit nga neni 1 i këtij ligji, Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, do të lidhë Marrëveshje të projektit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim."

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Projektin e implementon Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministrinë e Financave."

Neni 4

Pas nenit 5 shtohen tri nene të reja 5-a, 5-b, dhe 5-v, si vijojnë:

"Neni 5-a

Për mjetet e huas nga neni 1 i këtij ligji do të lidhet Marrëveshje për nënhua ndërmjet Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Neni 5-b

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga mjetet që do të grumbullohen me pagesën e mjeteve të huazuara të Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, sipas Marrëveshjes për nënhua nga neni 5-a i këtij ligji.

Neni 5-v

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve i kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, të dedikuara për realizimin e Projektit "Rehabilitimi i pjesës lindore të hekurudhës së Korridorit VIII, faza 1 segmenti Kumanovë-Belakovc", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e heqjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/shërbimeve nga Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, të dedikuara për realizimin e Projektit "Rehabilitimi i pjesës lindore të hekurudhës së Korridorit VIII, faza 1 segmenti Kumanovë-Belakovc", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrime doganore, si dhe nga akciza gjatë importit të automobilave dhe vajrave minerale.

Për qarkullimin e kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, për qëllime të realizimit të Projektit "Rehabilitimi i pjesës lindore të hekurudhës së Korridorit VIII, faza 1 segmenti Kumanovë-Belakovc", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, për të cilin i njëjti është obligues tatimor sipas nenit 32 pika 4 dhe nenit 32-a të Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar, lirohet nga obligimi për llogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Obliguesi tatimor që kryen qarkullim të liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar sipas paragrafit (1) të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të së mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë i shënon edhe emërtimin e projektit edhe emërtimin e Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup gjatë importit të të mirave të liruara sipas paragrafit (2) të këtij neni, organit kompetent doganor detyrimisht i dorëzon kopje të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/shërbimet e importuara janë të dedikuara për realizimin e Projektit "Rehabilitimi i pjesës lindore të hekurudhës së Korridorit VIII, faza 1 - segmenti Kumanovë-Belakovc", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji."

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".